

Fillimi > -Kronikë

EMRI/ Kapet 29-vjeçari në Korçë, lëvizte me pistoletë në makinë, sapo zbuloi se po ndiqej nga policia...

05 Qershor, 2020 11:49 |



Madhësia e tekstit:  

-  **KORÇË**
-  Policia e Korçës ka arrestuar një 29-vjeçar i cili lëvizte në makinë me një pistoletë me krehër me 7 fishekë.
- 
-  Në vijim të punës për rritjen e parametrave të sigurisë dhe informacioneve të siguruar në rrugë policore se një shtetas qarkullonte në qytet me armë zjarri, strukturat e Policisë Korçë menjëherë koordinuan veprimet, lokalizuan autorin e dyshuar dhe u vunë në ndjekje të tij.


Shtetasi Mateo Aliko, i cili po lëvizte me mjetin e tij tip “Volkswagen Touareg”, duke parë se ishte vënë në ndjekje nga Forcat e Posaçme Operacionale të DVP Korçë, për të shmangur përgjegjësinë penale, hodhi në një kosh mbeturinash në lagjen nr. 4, armën e zjarrit pistoletë tip “Glock” me 7 fishekë, e cila u gjet dhe sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Specialistët për hetimin e krimeve në Komisariatin e Policisë Korçë, bënë arrestimin në flagrancë të 29-vjeçarit, banues në Korçë, (me precedent të mëparshëm penal në fushën e krimeve kundër pronës e sigurisë publike) dhe materialet i referuan Prokurorisë të Rrethit Gjyqësor Korçë për veprën penale “Armëmbajtja pa leje”, për të cilën parashikohet dënimi me burgim deri në 7 vjet.

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)




Etiketa: [korce](#) [pistoletë](#)

TË NGJASHME





- **Shtrëktim i aktivitetit të paligjshëm të lojërave të fatit në Korçë, në kërkim pronari, arrestohet punëtori i tij**
07 Qershor, 2020
- **Gjendet i vdekur në banesë një 33-vjeçar në Korçë, dyshohet se...**
05 Qershor, 2020

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

- **Dëshmia tronditëse e shqiptares për "përbindëshin e Kavos": "Ai abuzoi me mua, më bëri video dhe kërcënoi të më vriste"**
07 Qershor, 2020
- **Ekzekutimi i vëllezërve Bardhi në Krujë, kushëriri i Roland Pulës tregon dinamikën e ngjarjes: Viktimat i thanë 'ku jeni ju trimat, të hani m...'**
07 Qershor, 2020
- **EMRI • FOTO/ Grabiste italianët, arrestohet shqiptari dhe bashkëpunëtori**
07 Qershor, 2020
- **EMRAT/ Qëlloi për vdekje bashkëkombasin në një bar në Itali, 12 vjet burg për vrasësin e kapur në Tiranë**
07 Qershor, 2020
- **Mediat italiane: Bllokohet gomonia me 3 kuintalë drogë në Lece, arrestohen kontrabandistët shqiptarë**
07 Qershor, 2020
- **VIDEO/ Digjet apartamenti në Torovicë të Lezhës, dëme të shumta materiale**
07 Qershor, 2020

KATEGORIA VIDEO

- **"Boll e goditët, o Zot, ndaloni! Del videoja e një tjetër afro amerikani të vrarë nga policia në SHBA"**
07 Qershor, 2020
- **(Video) Parashikimi i motit, 7 qershor 2020**
07 Qershor, 2020
- **(Video)Meta mesazh për "Zgjedhoren": Marrëveshja, hap i rëndësishëm! Do të kishte pasoja të rënda, nëse reforma do të ishte e njëanshme**
07 Qershor, 2020
- **FOTO/ Lihet në burg 37-vjeçari i arrestuar nga RENE në Kamëz, avokati: U hiperbolizua ngjarja, Kryemadhit iu gjet në banesë vetëm një thikë**
07 Qershor, 2020
- **(Video)Protesta për vdekjen e George Floyd, 5-vjeçarja afro amerikane i drejtohet policit: Do të më qëllosh? Ja si reagon ai**
07 Qershor, 2020
- **(VIDEO)Digjet banesa në Prrrenjas, shpëtojnë familjarët dhe e moshuara në gjumë**
06 Qershor, 2020